



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2019:219277

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05743856

C.nr. 424/2018

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË / Departamenti i përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Hatixhe Begaj, në çështjen juridiko-kontestimore të paditëses B. K. T. Kosovë SH.A., me adresë Rr. “U. H.” ,nr..., lagjja P. – Prishtinë, kundër të paditurve S. K.dhe F. K., që të dy nga fshati T. Komuna e Malishevës, për shkak të kthimit të borxhit, vlera e kontestit 1,292.80 euro, me datë 28.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET se padia e paditësit B. K. Tregtare K. SH.A. me seli në Prishtinë, me numër C.nr.424/2018 e datës 19.12.2018, në këtë çështje kontestimore, është **TËRHEQUR**.

A r s y e t i m

Paditësi B. K. T. Kosovë SH.A., me seli në Prishtinë,, pranë kësaj gjykate me datë 19.12.2018, ka parashtruar padi kundër të paditurve S. K. dhe F. K., që të dy nga fshati T. Komuna e Malishevës, për shkak të kthimit të borxhit në vlerë prej 1,292.80 euro.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje juridike kontestimore, ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi të dt.21.03.2022, të cilin aktvendim të paditurit e kishin pranuar me 29.03.2022, të njëjtit nuk kanë paraqitur përgjigje në padi, i cili fakt vërtetohet përmes fletëkthesave.

Paditësi me datë 29.03.2024 ka dorëzuar në gjykatë parashtrësën, me të cilën e ka njoftuar gjykatën se e tërheqin padinë meqenëse të paditurit i kanë përfunduar të gjitha obligimet ndaj bankës / paditëses në lidhje me kredinë sipas kontratës.

Me nenin 261 par. 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK) është paraparë se *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”* andaj meqenëse të paditurit nuk kanë paraqitur përgjigje në padi gjykata nuk ndërmori veprime tjera lidhur me pëlqimin e të paditurve për tërheqjen e kësaj padie.

Në këtë drejtim duke marrë parasysh bazën ligjore të lartcituar gjykata erdhi në përfundim se padia e paditësit B.K.e T. Kosovë SH.A., me seli në Prishtinë, kundër të paditurve S. K.dhe F. K., duhet të konstatohet e tërhequr.

Për arsyet e dhëna si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË

Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil

C.nr.424/2018, datë 28.05.2024

Gj y q t a r j a
Hatixhe Begaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.